



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 17, datë 18.01.2024

PËR

**PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...} NË POZICIONIN E “NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN” NË
NJËSINË E VLERËSIMIT PROFESIONAL DHE ETIK TË GJYQTARËVE NË
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimet e tij nr. 23, datë 14.01.2020 “Për komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve” dhe nr. 28, datë 20.01.2022 “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor,” me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.01.2024.
2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR